



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

NJOFTIM

**PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË PROKURORËVE
DHE
PROCEDURËN E ORGANIZIMIT TË VOTIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E
ANËTARËVE PROKURORË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË**

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neni 279, pika 6 dhe neneve 111 e vijues, pas hapjes së vendeve vakant për tre anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm thërret Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Bazuar në nenin 109, të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", u bë verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore pas mbylljes së afatit për dorëzimin e të shprehjeve të interesit, nën përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm. Sipas përcaktimeve të nenit 105, pika 2 dhe 4, të këtij ligji, rezultoi se kandidatët që kanë shprehur interesin, për të konkuruar në vendet vakante, plotësojnë kushtet ligjore për të kandiduar si anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë sipas Relacionit nr. 1259/7, datë 27.09.2021.

Njoftohen prokurorët e prokurorive të të gjitha niveleve, se mbledhja për efekt votimi, do të zhvillohet, ditën e premte, datë **15.10.2021, ora 08.ºº**, në godinën e "**Polit të Drejtësisë**".

Kandidatët për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë si më poshtë:

- Z. Sokol Stojani, prokuror, Prokuroria e Përgjithshme;
- Z. Ludovik Dodaj, prokuror, Prokuroria e Apelit Durrës;
- Z. Zeqir Hoda, prokuror, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë;
- Znj. Deniona Katro, prokuror, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë;
- Znj. Elona Alvora, prokuror, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë.

Nisur nga fakti se zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është një kërkesë e ligjit 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", e cila është e lidhur ngushtë me funksionim e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, lind detyrimi që organizimi i mbledhjes së prokurorëve dhe e gjithë procedura e votimit për anëtarët prokurorë të KLP-së të realizohet, duke marrë të gjitha masat në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, për të shmangur përhapjen e COVID-19.

Nga ana e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm janë marrë masat që kjo mbledhje të zhvillohet në mjediset e **Polit të Drejtësisë**, duke shmangur tubimin dhe grumbullimin e personave në

mjediset e brendshme dhe të jashtme të ndërtesës.

Me qëllim realizimin e këtij aktiviteti, procedurat e përcaktuara në ligjin 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe Rregullores Nr 3152/5 datë 11.12.2018, “Per procesin e votimit për përzgjedhjen e anëtarëve Prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, rregullat e regjistrimit të prokurorëve pjesëmarrës, të paraqitjes së platformave dhe të votimit, do të ndjekin rregullat e përcaktuara në aktet normativ dhe akte të tjera nënligjore të dala për të kufizuar përhapjen e Covid -19.

Në përputhje me parashikimet e ligjit nr.115/2016, prokurorët do të njihen me platformat e kandidatëve përmes postës elektronike, bashkëlidhur këtij njoftimi. Platformat do të publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Rregullat për mbarëvajtjen e procesit të votimit

- Ju kërkohet prokurorëve që të kenë maska mbrojtëse në momentin e regjistrimit, të votimit apo qendrimit në mjediset e jashtme të godinës dhe të përdorin dizifektantë.
- Ju kërkohet prokurorëve që të shmangin grumbullimet dhe qendrimet në grup si dhe të respektojnë oraret e përcaktuara.

Procedura e regjistrimit të prokurorëve sipas prokurorive

Me qëllim shmangien e grumbullimit të një numri të lartë personash në mjediset e votimit, regjistrimi do të kryhet sipas grafikut të mëposhtëm, me praninë e jo më shumë se tre prokurorëve njëkohësisht në mjedisin e posaçëm të regjistrimit.

Administrata e Prokurorisë së Përgjithshme do të mundësojë hyrjen e prokurorëve në mjediset e caktuara, në distancë të sigurt dhe duke përdorur mjetet për dizifektim, sipas rendit kronologjik të përcaktuar si më poshtë.

Orari i Regjistrimi (08:15 - 10:45):

08:15 - 08:20 Prokuroria e Përgjithshme;

08:20 - 08:30 Prokuroria e Posaçme;

08:30 - 09:00 Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, Prokuroria e Apelit Tiranë;

09:00 - 09:05 Prokuroria e Shkallës së Parë Krujë;

09:05 - 09:15 Prokuroria e Shkallës së Parë Durrës, Prokuroria e Apelit Durrës;

09:15 - 09:25 Prokuroria e Shkallës së Parë Elbasan;

09:25 - 09:30 Prokuroria e Shkallës së Parë Kurbini, Mat;

09:30 - 09:35 Prokuroria e Shkallës së Parë Lezhë;

09:35 - 09:45 Prokuroria e Shkallës së Parë Shkodër, Prokuroria e Apelit Shkodër

09:45 - 09:50 Prokuroria e Shkallës së Parë Pukë, Kukës;

09:50 - 09:55 Prokuroria e Shkallës së Parë Kavajë;

09:55 - 10:00 Prokuroria e Shkallës së Parë Lushnjë;

10:00 - 10:05 Prokuroria e Shkallës së Parë Fier;

10:05 - 10:10 Prokuroria e Shkallës së Parë Berat, Përmet;

10:10 - 10:20 Prokuroria e Shkallës së Parë Vlorë, Prokuroria e Apelit Vlorë;

10:20 - 10:30 Prokuroria e Shkallës së Parë Gjirokastrë, Sarandë, Apeli Gjirokastrë;

10:30 - 10:40 Prokuroria e Shkallës së Parë Pogradec, Korçë, Prokuroria e Apelit Korçë;

10:40 - 10:45 Prokuroria e Shkallës së Parë Dibër, Tropojë.

- 30 min pushim

Përcaktimi i Kuorimit për Votim

Prokurori i Përgjithshëm konform përcaktimeve të nenit 112 të Ligjit 115/16, pasi sigurohet për praninë e më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të prokurorëve, njofton për numrin e prokurorëve pjesëmarrës në votim me anë të emailit si dhe me shpallje në ambientet ku do të mbahet procedura e votimit.

Nëse të pranishëm do të jenë më tepër se gjysma e prokurorëve, përmes këtyre njoftimeve (me email dhe shpallje) do të ftohen prokurorët të votojnë në ambientet e godinës së Polit të Drejtësisë.

Procedura e Votimit të prokurorëve sipas prokurorive

Me qëllim shmangien e grumbullimit të një numri të lartë personash në mjediset e votimit, votimi do të kryhet sipas grafikut të mëposhtëm, me praninë e jo më shume se tre prokurorëve njëkohësisht në mjedisin e posaçëm të votimit.

Administrata e Prokurorisë së Përgjithshme do të mundësojë hyrjen e prokurorëve në mjediset e caktuara, në distancë të sigurt dhe duke përdorur mjetet për dizifektim, sipas rendit kronologjik të përcaktuar si më poshtë.

Orari i Votimit (11:15 - 14:00):

- 11:15 - 11:20** Prokuroria e Shkallës së Parë Dibër, Tropojë;
- 11:20 - 11:30** Prokuroria e Shkallës së Parë Pogradec, Korçë, Prokuroria e Apelit Korçë ;
- 11:30 - 11:40** Prokuroria e Shkallës së Parë Vlorë, Prokuroria e Apelit Vlorë;
- 11:40 - 11:50** Prokuroria e Shkallës së Parë Gjirokastër, Sarandë, Apel Gjirokastër ;
- 11:50 - 12:00** Prokuroria e Shkallës së Parë Vlorë, Prokuroria e Apelit Vlorë;
- 12:00 - 12:05** Prokuroria e Shkallës së Parë Berat, Përmet ;
- 12:05 - 12:10** Prokuroria e Shkallës së Parë Fier;
- 12:10 - 12:15** Prokuroria e Shkallës së Parë Lushnjë;
- 12:15 - 12:20** Prokuroria e Shkallës së Parë Kavajë;
- 12:20 - 12:25** Prokuroritë e Shkallës së Parë Pukë, Kukës;
- 12:25 - 12:35** Prokuroria e Shkallës së Parë Shkodër, Prokuroria e Apelit Shkodër;
- 12:35 - 12:40** Prokuroria e Shkallës së Parë Lezhë;
- 12:40 - 12:45** Prokuroria e Shkallës së Parë Kurbin, Mat;
- 12:45 - 12:55** Prokuroria e Shkallës së Parë Elbasan;
- 12:55 - 13:05** Prokuroria e Shkallës së Parë Durrës, Prokuroria e Apelit Durrës;
- 13:05 - 13:10** Prokuroria e Shkallës së Parë Krujë;
- 13:10 - 13:40** Prokuroria e Shkallës së Parë Tiranë, Prokuroria e Apelit Tiranë;
- 13:40 - 13:50** Prokuroria e Posacme;
- 13:50 - 14:00** Prokuroria e Përgjithshme;

Administrimi i procesit

Më mjediset ku do të zhvillohet procesi i regjistrimit dhe votimit do të jenë të pranishëm;

- Anëtarët e Komisionit të Votimit.
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë.

- Anëtarë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kuvendi i Shqipërisë.

Gjatë procesit të votimit, verifikimit të procesverbaleve, hapjes së kutive dhe numërimit të votave, kandidatët mund të qëndrojnë në sallë ose të autorizojnë jo më shumë se një përfaqësues të tyre.

Media do të jetë e ftuar dhe mund ta ndjekë drejtpërsëdrejti procesin në mjediset e posaçme që ofron Poli i Drejtësisë, duke respektuar masat e përcaktuara nga Komiteti i Ekspertëve për shmangien e përhapjes së COVID 19.

Shpallja e rezultatit

Shpallja e rezultateve do të njoftohet brenda ditës së votimit, në adresat zyrtare të emailit, faqen e Prokurorisë së Përgjithshme dhe në media.

Vendimi i shpalljes së rezultatit do të shpallen zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, jo më vonë se 24 orë nga mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.

Vendimi për shpalljen e fituesve dërgohet nga Prokurori i Përgjithshëm për t'u botuar në Fletoren Zyrtare, në përputhje me nenin 115/ 7 të ligjit 115/2